



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA DELVINË  
POLICIA BASHKIAKE

Nr. 1068 Prot

Delvinë më, 06 . 05 .2022

**NJOFTIM PËR SHPALLJE PUBLIKE**

**Z.ASTRIT MEÇE**

Bazuar në Ligjin Nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, KREU II, Mënyrat dhe mjetet e njoftimit, Neni 162 pika 1,

1.Njoftim Publik bëhet në këto raste:

**b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi;**

**c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur;**

Ndodhur në kushtet se çdo formë njoftimi është e pamundur për të informuar Z.Astrit Mece për shkresën me Nr.764/2 Prot, datë 08.04.2022 me lëndë “Njoftim” dhe shkresën Nr.764/3 Prot, datë 08.04.2022 me lëndë “Njoftim për lirim të hapësirës Publike” dhe Procesverbali i Konstatimit të Kundërvajtjes me Nr.000130 Serie. Duke qënë se shkresat e mësipërme nuk janë marrë në dorëzim nga ana juaj edhe pse janë dërguar me postë zarfi me kod RR038737458 AA dhe zarfi me kod RR033878428AA.

**PËR KËTË ARSYE:**

Bazuar në Ligjin Nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, Neni 162 pika 2,

**2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet.**

Bazuar në Ligjin Nr.8224 datë 15.05.1997 “Për Policinë Bashkiake” i ndryshuar, nga kontrolli në terren është konstatuar kundërvajtja:

Bazuar në Ligjin Nr.8224 datë 15.05.1997 "Për Policinë Bashkiake" i ndryshuar, nga kontrolli në terren është konstatuar kundërvajtja:

- **Zënia e hapësirës publike, konkretisht me kontenier, pa lejen apo autorizimin e bashkisë apo autoritetit përgjegjës për mirëmbajtjen edhe menaxhimin e hapësirës publike.**

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1096 datë 28.12.2015 "Për Miratimin e Rregullave Kushteve e Procedurave për Përdorimin dhe Menaxhimin e Hapësirës Publike" botuar në Fletoren Zyrtare Nr.243, viti 2015 neni 11 pika 1 Zënia e Hapësirës Publike "**Është e ndaluar zënia, edhe përkohësisht me cfarëdo lloji objekti, e hapësirës publike dhe hapësirave mbi ose nën të, pa lejen apo autorizimin e bashkisë apo autoritetit përgjegjës për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre**". Duke qënë se juve nuk dispononi leje apo autorizim nga Bashkia Delvinë apo autoriteti përgjegjës për mirëmbajtjen edhe menaxhimin e hapësirave publike konkretisht për kontenierin nga ana e Policisë Bashkiake është mbajtur Procesverbal i Konstatimit të Kundërvajtjes me Nr.000130 Serie.

Bazuar në Vendimin Nr.1096 datë 28.12.2015 "Për Miratimin e Rregullave Kushteve e Procedurave për Përdorimin dhe Menaxhimin e Hapësirës Publike" neni 14 Sanksionet "**Shkelja e detyrimeve të mësipërme kur nuk përbën veper penale apo kundërvajtje administrative sipas ligjeve të vecanta, dënohet në bazë të akteve të këshillit bashkiak, brenda juridiksionit të caktuar territorial**".

Në mbështetje të paketës Fiskale viti 2022 Bashkia Delvinë, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.45 datë 01.12.2021 dhe me shprehjen e ligjshmërisë së Prefektit të Qarkut Vlorë me Nr.964/1 Prot, datë 22.12.2021. **Zënia e hapësirave publike pa leje dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.**

Bazuar në nenin 8 pika 6 Policia e Bashkisë dhe e Komunës ka për detyrë:

- **Të ndalojë, shmangë e prishë ndërtimet e paligjshme, të ndalojë zënit e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të bashkisë apo komunës si dhe të organizojë lirimin e tyre.**

**Ju njoftojmë të kryeni lirimin vullnetar të hapësirës publike, duke larguar kontenierin brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit. Në rast të kundërt, do të merren masa për lirimin e hapësirës publike dhe sekuestrimin e kontenierit nga Policia Bashkiake, Bashkia Delvinë.**

- 1.Njoftimi publik do të afishohet në këndin e njoftimeve të Bashkisë Delvinë.
- 2.Njoftimi publik do të afishohet në këndin e njoftimeve në Njësinë Administrative Vergo.
3. Njoftimi publik do të afishohet te Kontenieri, me vendodhje në fshatin FushëVërri.

Bazuar në Ligjin Nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, Neni 162 pika 3

3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara.

Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

**KRYETARI I BASHKISË**

Majlinda Qilimi

